



USHTRIA



Viti i 76-të i botimit Nr. 34 (827838)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 25 gusht 2023

Kontingjenti "KFOR-3" përfundon me sukses misionin në Pejë, Kosovë

Në ambientet e Forcës Tokësore u zhvillua ceremonia e pritjes së Kontingjentit "KFOR-3", i cili përfundoi me sukses detyrën gjatshëmujore si pjesë e misionit të NATO-s, në Pejë, Kosovë. Në këtë ceremoni morën pjesë komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia, shefi i Shtabit i Forcës Tokësore, kolonel Beqir Tafili, komandanti i Batalionit të Dytë të Këmbësorisë, major Enerjol Harka, si dhe shefat e degëve të Forcës

Tokësore. Komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia, pasi i uroi mirëseardhjen në atdhe kontingjentit, ndër të tjera tha: "Ju shpalosët atje një vlerë të lartë të ushtarakut shqiptar. Por, po kaq e rëndësishme, në mos më e vyer, është përvoja e shtuar që ju sollët këtu, një përvojë unike, e cila do të shërbejë për të përgatitur e trajnuar ushtarakët e tjerë të kontingjentëve pasardhës. Kam kënaqësinë, që në

mënyre të veçantë t'iu shpreh respektin dhe mirënjohjen time, familjarëve të misionarëve, për mbështetjen që iu dhanë bijve dhe familjarëve të tyre, duke ua bërë më të lehtë qëndrimin atje." Gjeneral brigade Ilir Xhebexhia e mbylli fjalën e tij me urimet më të ngrohta dhe më të sinqerta për pjesëtarët e kontingjentit dhe familjarët e tyre. Kontingjenti "KFOR-3",...

» faqe 2



Situata e zjarreve në vend

Ministri Peleshi: Të përkushtuar për sigurinë dhe mirëqenien e qytetarëve tanë!



» faqe 3

OSFA, sukses i radhës në Umbria të Italisë

Bashkëpunimi mes Formacionit Barok të Forcave të Armatosura dhe Hermans Festival, solli një performancë mahnitëse të Orkestrës tonë Simfonike në Umbria të Italisë. Në atmosferën magjike që OSFA ofron në çdo performancë të saj, kësaj here për publikun italian, artistët tanë shpalosën talentin dhe aftësitë e tyre artistike në interpretimin e muzikës baroke. Performancën e OSFA-së, organizatorët e këtij festivali...



» Faqe 2

"Dua që vajzat e vogla të rriten duke ditur se mund të bëjnë gjithçka, macje edhe të luajnë futboll"

Barazia gjinore, padyshim, është faktor i rëndësishëm për zhvillimin e një shoqërie. Përmirëson produktivitetin dhe rritjen ekonomike, ndikon pozitivisht në mirëqenien e grupeve të ndryshme shoqërore dhe, në këtë mënyrë, kontribuon në zhvillimin e shoqërisë dhe gjeneratave të ardhshme, si dhe në efikasitetin e institucioneve. Pjesëmarrja aktive e grave në jetën publike e private të një vendi është sa një e drejtë aq edhe një domoshmëri. E drejtë, pasi është e shkruar...



» Faqe 5

Samiti i Vilnius-it, sfidat e së ardhmes së NATO-s

Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO) ka qenë një gur themeli i sigurisë për vendin tonë, rajonin dhe sigurinë mbarëbotërore. Përparimi i saj, i karakterizuar nga fleksibiliteti dhe qëndrueshmëria, është formuar kryesisht nga peizazhi gjeopolitik në ndryshim dhe qëllimet strategjike me ndikim për vendet anëtare të saj. Ndryshimet gjeopolitike në vite dhe zhvillimi i NATO-s ndahet kryesisht në katër periudha unike, secila pasqyron rrethanat globale të epokës së saj: epoka e mbushur me Luftën e Ftohtë, vitet e pasigurta pas Luftës...



» Faqe 8

Kontingjenti "KFOR-3" përfundon me sukses misionin në Pejë, Kosovë

Në ambientet e Forcës Tokësore u zhvillua ceremonia e pritjes së Kontingjentit "KFOR-3", i cili përfundoi me sukses detyrën gjashtëmujore si pjesë e misionit të NATO-s, në Pejë, Kosovë. Në këtë ceremoni morën pjesë komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia, shefi i Shtabit i Forcës Tokësore, kolonel Beqir Tafili, komandanti i Batalionit të Dytë të Këmbëorisë, major Enerjol Harka, si dhe shefat e degëve të Forcës Tokësore.

Komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia, pasi i uroi mirëseardhjen në atdhe kontingjentit, ndër të tjera tha: "Ju shpalosët atje një vlerë të lartë të ushtarakut shqiptar. Por, po kaq e rëndësishme, në mos më e vyer, është përvoja e shtuar që ju sollët këtu, një përvojë unike, e cila do të shërbejë për të përgatitur e trajnuar ushtarakët e tjerë të kontingjenteve pasardhëse. Kam kënaqësinë, që në mënyrë të veçantë t'iu shpreh respektin dhe mirënjohjen time, familjarëve të misionarëve, për mbështetjen që iu dhanë bijve dhe familjarëve të tyre, duke ua bërë më të lehtë qëndrimin atje." Gjeneral brigade Ilir Xhebexhia e mbylli fjalën e tij me urimet më të ngrohta dhe më të sinqerta për pjesëtarët e kontingjentit dhe familjarët e tyre.

Kontingjenti "KFOR-3", pjesë



Kompanisë së Dytë të Batalionit të Dytë të Këmbëorisë, pasi realizoi detyrën për një periudhë 6 - mujore në kuadër të misionit të NATO-s, i dorëzoi autoritetin Kompanisë së Tretë të Batalionit të Dytë të Këmbëorisë.



OSFA, sukses i radhës në Umbria të Italisë

Bashkëpunimi mes Formacionit Barok të Forcave të Armatosura dhe Hermans Festival, solli një performancë mahnitëse të Orkestrës tonë Simfonike në Umbria të Italisë.

Në atmosferën magjike që OSFA ofron në çdo performancë të saj, kësaj here për publikun italian, artistët tanë shpalosën talentin dhe aftësitë e tyre artistike në interpretimin e muzikës baroke.

Performancën e OSFA-së, organizatorët e këtij festivali prestigjioz e vlerësuan maksimalisht për virtuozeitetin, nivelin artistik dhe atë profesional të artistëve, supet e të cilëve zbukurohen nga spaletat ushtarake, vlerë e shtuar për këta artistë "të veçantë".



ROS, pjesë e stërvitjes "JCET-23"

Operatorët e Regjimentit të Operacioneve Speciale përfunduan me sukses stërvitjen përgatitore para pjesëmarrjes në stërvitjen e përbashkët me Forcat Speciale Amerikane "JCET-23", që do zhvillohet në Maqedoninë e Veriut. Kjo stërvitje është shumë e rëndësishme për rritjen e nivelit të ndërveprueshmërisë, sinkronizimit të procedurave operacionale dhe zhvillimit të aftësive në realizimin e operacioneve speciale.



Specialistët EOD eliminuan rrezikun nga municionet e paplasura në bashkitë Dimal e Librazhd

Specialistët EOD të batalionit të xhenios realizuan dy operacione për eliminimin e municioneve të paplasura. Operacionet u kryen në bashkitë Dimal e Librazhd.

Në fshatin Allambres, Njësia Administrative Cukalat, bashkia Dimal, ekipi EOD bëri kontrollin mbitokësor dhe nëntokësor të një sipërfaqeje rreth 185 m². Kontrolli nëntokësor u bë me aparatën Ferex 4032. Në përfundim të kontrollit u zbulua dhe identifikua një municion i paplasur që ishte granatë dore mësymëse e paarmatosur me ndezës të unifikuar.

Operacioni tjetër u krye në njësinë administrative Mirakë, bashkia Librazhd. Pas rikonicionit nga grupi EOD u konstatua një predhë mortaje E-TH. Municionet e zbuluara u konsideruan të prekshëm dhe të lëvizshëm duke bërë transportimin e sigurt të tyre. Të dy operacionet përfunduan me sukses.



SITUATA E ZJARREVE NË VEND

Ministri Peleshi: Të përkushtuar për sigurinë dhe mirëqenien e qytetarëve tanë!

50 efektivë të Forcave të Armatosura, helikopteri "Cougar", 2 mjete zjarrfikëse të FA-së dhe 4 mjete zjarrfikëse nga MZSH Kamëz, Lezhë dhe Mirditë janë mobilizuar për të ndihmuar në shuarjen e zjarrit masiv në bashkinë e Kurbinit. Situata është sfiduese për shkak të terrenit të vështirë, ku zjarri është përhapur me shpejtësi.

"Të përkushtuar për sigurinë dhe mirëqenien e qytetarëve tanë! Të gjithë bashkë, të angazhuar në luftën kundër zjarrvënies së qëllimshme. Dënimi i zjarrvënies në pyje me deri në 15 vjet burg tregon vendosmërinë e institucioneve tona ndaj këtij veprimi kriminal.

Përgëzime Policisë së Shtetit për punën e tyre në identifikimin dhe arrestimin e dy zjarrvënësve në malin Partizan", - u shpreh ministri i mbrojtjes Niko Peleshi, mbi situatën aktuale të zjarreve në territorin tonë.

Informimi i shpejtë dhe koordinimi i autoriteteve janë thelbësore për të parandaluar katastrofat e mëdha.

Forcat e Armatosura dhe Agjencia e Mbrojtjes Civile janë gjithmonë në gatishmëri në mbrojtje të jetës, sigurisë dhe pronës së qytetarëve tanë përballë çdo rreziku që mund të paraqitet qëllimisht nga zjarrvënës të papërgjegjshëm.

Situata e zjarreve në territorin e vendit paraqitet më e mirë, gjatë orëve të fundit.

Pas një pune të gjatë të trupave të emergjencave civile në bashkëpunim me efektivë të FA-së, nën koordinimin e Agjencisë së Mbrojtjes Civile është bërë e mundur shuarja e pjesës më të madhe të vatrave.

Në qarkun e Korçës ka një vatër aktive zjarri, në fshatin Arrëz, të bashkisë Kolonjë, e cila u riaktivizua pas izolimit të dy ditëve më parë. Situata është nën kontroll.

Puna vijon edhe në malin Stilos, në bashkinë Konispol dhe fshatin Grazhdan, të bashkisë Finiq, ku efektivë zjarrfikës po punojnë për shuarjen e vatrave të zjarreve.

Në fshatin Jarua, në bashkinë e Fierit zjarri është shuar dhe po bëhet kontrolli i zonës.

Puna ka vijuar deri në shuarjen përfundimtare të zjarreve në njësinë administrative Vergo të bashkisë Delvinë, në njësinë administrative Lopes të bashkisë Tepelenë, në Semens të Lushnjës, në fshatin Gur i Zi të bashkisë Elbasan dhe në lagjen Çlirim, bashkia Berat.

Forcat e Armatosura, nën koordinimin e Agjencisë së Mbrojtjes Civile, kanë bërë të mundur shuarjen përfundimtare të vatrave aktive të zjarrit në fshatin Delbnisht, në Njësinë Administrative Milot, bashkia Kurbin. Në kurorën e qytetit të Laçit, afër Kishës së Shën Antonit, aty ku situata ishte



tejet kritike, që prej ditës së djeshme, vatrave të zjarrit janë shuar përfundimisht. Momentalisht, situata është e qetë dhe po monitorohet nga punonjësit e zjarrfikëses dhe shërbimit pyjor.

Gjithashtu është bërë e mundur

shuarja e një vatre zjarri pranë superstradës Milot-Lezhë.

Në fshatin Treblovë, në bashkinë e Selenicës të qarkut Vlorë, zjarri është arritur të shuhet plotësisht. Falë ndërhyrjes në kohë me helikopter u bë

i mundur shpëtimi i 4 shtëpive.

Po punohet me intensitet për mbajtjen nën kontroll të vatrave të zjarrit në fshatin Jarua, bashkia Fier, ku është shmangur rreziku për banesat.

Në fshatin Sinanaj, në bashkinë Te-

pelenë, punohet nga terreni për izolimin e vatrës së zjarrit.

Puna vijon edhe në fshatin Grazhdan, në bashkinë e Finiqit për normalizimin e vatrës pas riaktivizimit. FARSH, gjithmonë pranë komunitetit.

"Cougar" normalizon situatën në bashkinë e Selenicës

Pas një pune të gjatë të trupave të emergjencave civile në bashkëpunim me 30 efektivë të Repartit të Poshnjës, nën koordinimin e Agjencisë së Mbrojtjes Civile është bërë e mundur shuarja e zjarrit në fshatin Treblovë, në bashkinë Selenicë. Për shkak të terrenit të vështirë dhe përhapjes së vatrave të zjarrit nga era e fortë, u desh ndërhyrja nga ajri e helikopterit "Cougar" për normalizimin deri në shuarjen përfundimtare të tij.



Shtypi ushtarak në vitet e demokracisë



Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj

Në fillesat e demokracisë


Numri i parë i gazetës “Ushtria dhe koha” në vitin 1992, doli në formatin A3, me 8 faqe e më pas me 16 faqe. Kjo gazetë vijoi të trajtonte problemet ushtarake, të para në këndvështrimin e ri politik e shoqëror të vendit, mjaft e çliruar politikisht. Gazeta ushtarake trajtonte probleme të ndryshme, që kishin të bënin me jetën ushtarake si dhe me traktatet, aleancat, misionet dhe organizimin e ri të ushtrisë shqiptare, sipas kërkesave të kohës. Vijoi botimin deri në marsin e vitit 1997.

“Ushtria dhe koha” ishte një tjetër revistë që doli në vitin e vështirë ekonomik 1992, pranë Ministrisë së Mbrojtjes, si vijim i revistës “10 korriku”. Paralelisht, po me këtë emër, dilte edhe gazeta e ministrisë. Kjo revistë nuk e pati jetën e gjatë, vetëm një vit e gjysmë dhe nga fillimi i vitit 1993 pushoi së ekzistuar.

“Ushtria”, gazetë ushtarake e dalë në vitin 1997, pas trazirave që ndodhën për shkak të ndryshimeve politike në vend. Staf i drejtues i ri i ndryshoi emrin gazetës, duke e quajtur thjesht “Ushtria”. Misioni i gazetës ishte pasqyrimi i reformave dhe ndryshimeve në ushtri. Gjatë kësaj periudhe një vend të rëndësishëm zuri Lufta e Kosovës dhe gjithë zhvillimet e saj në faqet e gazetës. Njëherësh kjo gazetë priti dhe shekullin e ri, ku u bë frymëzuese, aspiruese, mbështetëse e objektivave të Ushtrisë Shqiptare për të qenë pjesë e NATO-s, gjë që u arrit me shumë dinjitet. Sot kjo gazetë vijon misionin e saj, me këtë emër, si një organ dinjitoz i një Force të Armatosur po aq dinjitoze. Kjo gazetë nga marsi i vitit 2014 filloi të botohet elektronikisht në faqen zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

Në kushtet kur Akademia Ushtarake e Shtabit të Përgjithshëm detyrën kryesore kishte procesin e mësimdhënies, ndërkohë ajo ishte edhe një qendër e rëndësishme shkencore e ushtrisë. Ministri i Mbrojtjes nxori urdhrin nr. 15, datë 18.01.1992 për botimin e “Revistës Ushtarake” si organ teoriko-shkencor në Akademinë Ushtarake të Shtabit të Përgjithshëm. Objekti kryesor i revistës ishte zbrërthimi e trajtimi teoriko-shkencor i problemeve kryesore të artit ushtarak në shkallë të ndryshme, të historisë ushtarake të vendit tonë dhe të shteteve të huaja, si dhe tema të përvojës, të teknikës e armatimit bashkëkohor të ushtrive të huaja dhe të marrëdhënieve ndërkombëtare në fushën politiko-ushtarake. Revista kishte kolegjiunin e saj të përbërë prej 21 vetash dhe kryeredaktor ishte nënkolonel Xhemil Çela. Revista Ushtarake pati një jetëgjatësi të shkurtër 3 vjeçare, duke ndërprerë aktivitetin e saj.

“Mbrojtja” ishte një tjetër organ profesional që pa dritën e botimit pranë Ministrisë së Mbrojtjes. Revista “Mbrojtja” doli në numrin e



parë të saj në mesin e vitit 1992. Kjo revistë u formatua nga një staf i ri, me emra të rinj, me vizione të reja dhe shumë shpejt revista u bë pararojë e ndryshimeve të domosdoshme edhe në ushtrinë shqiptare. Revista ishte në shërbim të ushtarëve, të problemeve të tyre, më e çliruar, më shumë argëtuese, edukative dhe informuese.

Botimet pas rigrutjes së ushtrisë në vitin 1997

Revista “Mbrojtja”, organ ushtarak-kulturor i Ministrisë së Mbrojtjes - kështu u quajt nga stafi i ri që erdhi në krye të MM në vitin 1997 në revistën “Mbrojtja”. Kështu në emërtimin e revistës u përfshi dhe fjalën “Revista”. Me këtë emër “Revista Mbrojtja” është bërë një organ i specializuar ushtarak, periodik, në formatin A4, me 54 faqe me ngjyra, duke vijuar traditën e botimit deri më sot. Nga marsi i vitit 2014 kjo revistë botohet elektronikisht. Ndërsa në dhjetor të vitit 2022 kjo revistë pa dritën e botimit dhe arriti të botohej në 100 faqe. Në muajt janar dhe shkurt 2023 revista doli në 52 faqe, ndërsa nga muaji mars 2023 revista del në çdo tre muaj me 100 faqe.

Në vitin 2002 nisën botimin një sërë gazetash dhe revistash të Forcave dhe të Komandave Mbështetëse, për informim të brendshëm të njësive dhe reparteve të këtyre njësive. Misioni i tyre ishte pasqyrimi i gjithë aktiviteteve të Forcave dhe Komandave Mbështetëse, publikimi i planeve të transformimit dhe modernizimit të tyre, si dhe historikët, veprës së brezave të tyre. Të tilla ishin gazeta “Fjala e Tokësorit”

e Forcave Tokësore, si dhe revistat “Forcat Ajrore”, “Detari” dhe revista e Komandës Mbështetëse etj.

Me reformimin e ushtrisë dhe konsolidimin e Forcave të Armatosura u krijua Komanda e Doktrinave dhe e Stërvitjes, ku në përbërje të saj u krijua dhe dega e botimeve, si organizëm më vete, në përbërje të Qendrës së Doktrinave, Manualeve dhe Botimeve, sot Instituti Kërkimit Shkencor Ushtarak, në Akademinë e Forcave të Armatosura. Një nga detyrat kryesore të saj ishte dhe botimi i Revistës Ushtarake si organ teoriko-shkencor i Komandës së Doktrinës dhe të Stërvitjes, e cila do të luante rol parësor për shkëmbimin e lirë të mendimeve nga kadri oficer, për trajtimin e materialeve teoriko-shkencor, etj. Qëllimi i saj ishte të kontribuonte në zbrërthimin e trajtimin sa më shkencor të teorisë e të doktrinës sonë ushtarake në përputhje me kushtet e zhvillimit bashkëkohor, të ndihmojë kuadrin oficer në zgjerimin e njohurive të tyre ushtarake, sidomos atyre të shtabeve e të reparteve, akademistëve e studentëve. Ajo synonte në zhvillimin bashkëkohor të shkencës ushtarake. Revista i parapriu dhe i hapi rrugë mendimit të lirë debatues e në frymë konstruktive, për idetë, mendimet e trajtuara nga autorë të ndryshëm si bashkëpunëtorë të revistës.

Në vitin 2002 revista ushtarake pa dritën e botimit në dy numra të saj. Në to u trajtuan

Prof. Proletar Hasani, Komisioni i Kualifikimit Shkencor pranë Këshillit të Ministrave, e klasifikoi Revistën Ushtarake si revistë shkencore më datë 10 dhjetor 2003. Numri i parë i vitit 2004 i Revistës Ushtarake hyri në histori si numër i klasifikuar shkencor në bazë të ligjeve që vepronin në Republikën e Shqipërisë dhe si e vetmja revistë shkencore në FA. Kjo revistë doli deri në fund të vitit 2005, për të rivazhduar përsëri nga viti 2008 dhe deri më sot.

“Krenaria ushtarake”, gazetë e Shoqatës së Bashkuar të Ushtarakëve në Rezervë që nisi botimin në vitin 2000. Gazeta kishte 16 faqe dhe doli në 28 numra, duke trajtuar kryesisht probleme të ushtarakëve në lirim e në rezervë si dhe probleme të së kaluarës. Vijoi botimin deri në vitin 2008.

“Zëri i ushtarakut” nisi botimin në vitin 2009, si gazetë më vete, pasi më parë dilte si suplement ushtarak i gazetës “Ndryshe”. Gazeta trajtonte problemet e ushtarakëve të liruar, kryesisht.

“Aleanca ushtarake” ishte gazeta ushtarake, organ i Aleancës Kombëtare të Ushtarakëve të Shqipërisë dhe filloi botimin në mesin e vitit 2010, si një gazetë periodike me 12 faqe. Gazeta trajtonte edhe kjo probleme të ushtrisë dhe jetës së ushtarakëve si dhe probleme të ndryshme kulturore kombëtare e ndërkombëtare.

Revista “Studime për Historinë Ushtarake”, organ shkencor i Institutit të Studimeve të Historisë Ushtarake, nisi botimin në vitin 2006. Në faqet e kësaj reviste kanë gjetur pasqyrim studimet shkencore në fushën e Historisë Ushtarake Shqiptare, si



probleme të politikës së sigurimit e të mbrojtjes, koncepte doktrinale e të stërvitjes, probleme të historisë ushtarake e të terminologjisë, probleme

të arsimit ushtarak, trajtesa të kolegjit të mbrojtjes etj., me rreth 40 artikuj të shkruar nga gjeneralë, profesorë, pedagogë, kuadro, akademistë e studentë. Në vitin 2003 në Revistën Ushtarake janë shkruar artikuj nga Presidenti, Kryeministri, Ministri i Mbrojtjes, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, si dhe gjeneralë, profesorë, veteranë, komandantë të llojeve të armëve e shërbimeve e figura të tjera publike të vendit dhe të ushtrisë. Në vitin 2003 Revista Ushtarake pa dritën e botimit në katër numra dhe janë shkruar rreth 80 artikuj. Pas kërkesës së bërë nga ish-komandanti i Komandës së Doktrinës dhe të Stërvitjes, gjeneralmajor Perlat Sula dhe oponencës së bërë nga

botime e promovime librash shkencorë, tekste mësimore për shkollat e akademitë ushtarake, monografi, materiale shkencore dhe njohëse për studimin, evidentimin dhe publikimin e dukurive, ngjarjeve dhe të personaliteteve të Historisë Ushtarake Shqiptare e më gjerë (në rajon) etj., organizim seminaresh, sesionesh dhe konferencash për diskutimin dhe bërjen të njohur, të dukurive e risive të ndryshme apo të studimeve me karakter shkencor dhe edukativ nga fusha e Historisë Ushtarake etj.

Kjo ishte një panoramë fragmentare e shtypit ushtarak në 32 vjet jetë, të nisura nga viti 1991. Në këtë shkrim njohës dhe përshkruar shikohet se numri i gazetave dhe revistave ushtarake në kohë të ndryshme ka pasur ngjitje dhe ulje, por kurdoherë ka qenë i vlerësuar dhe i ndjekur me vëmendje nga stafet e tyre, por dhe nga drejtuesit e institucioneve dhe të dikastereve përkatëse. E rëndësishme dhe themelore për këto gazeta dhe revista, ka qenë përkushtimi i madh dhe i vëmendshëm ndaj jetës dhe karrierës së ushtarakut, formimit dhe edukimit të tyre, etj.



"Dua që vajzat e vogla të rriten duke ditur se mund të bëjnë gjithçka, madje edhe të luajnë futboll"

Barazia gjinore, padyshim, është faktor i rëndësishëm për zhvillimin e një shoqërie. Përmirëson produktivitetin dhe rritjen ekonomike, ndikon pozitivisht në mirëqenien e grupeve të ndryshme shoqërore dhe, në këtë mënyrë, kontribuon në zhvillimin e shoqërisë dhe gjeneratave të ardhshme, si dhe në efikasitetin e institucioneve.

Pjesëmarrja aktive e grave në jetën publike e private të një vendi është sa një e drejtë aq edhe një domosdoshmëri. E drejtë, pasi është e shkruar në kushtetutën dhe ligjet e vendit. Domosdoshmëri, pasi t'i mohosh apo të mos inkurajosh përafërsisht gjysmën e popullatës të mos vendosë aktivisht në shërbim të saj dhe të shoqërisë kapacitetin njerëzor (mendtor dhe emocional) që ajo mbart përkthehet në një inefficencë ekonomike të pafalshme. Kjo bëhet edhe më e rëndësishme në një vend si Shqipëria, ku pavarësisht ecurisë së vërejtur gjatë 23 viteve të fundit, nevoja për një zhvillim të mëtejshëm ekonomik mbetet jetike.

Në tërësi gratë janë anëtare/pjesëmarrëse më të mira për të punuar në ekip/ grup. Natyra apo edhe aspekti tradicionalist i shoqërisë tonë i ka shtyrë gratë drejt një komunikimi më aktiv në jetën e përditshme, kulturë komunikimi e cila përkthehet në një vlerë/avantazh të nevojshëm për të punuar mirë në grup.

Gratë nuk janë, nuk kanë sesi të jenë, thjesht një numër, diçka më shumë apo më pak se gjysma e popullsisë. Ato luajnë role kyçe në formësimin e jetës sonë. Shoqëria tradicionale i sheh ato në rolin e nënës, mësueses, gruas. Por pjesëmarrja dhe kontributi i tyre, gjithmonë e më i njohur, gjithnjë e më i formalizuar, shtrihet në çdo pjesë të jetës. Sa më shumë të bëhen prezente femrat në rolet e ashtuquajtura jo-tradicionale, aq më shumë impakt krijojnë, aq më shumë kreativitet, vlerë, praktikitet dhe energji sjellin ato.

Gratë në pushtet zënë pozicione që iu falin autoritet, ndikim dhe në të njëjtën kohë përgjegjësi.

Historikisht pushteti dhe pozicionet drejtuese kanë qenë më gjerësisht të zotëruar nga burrat, duke shënuar një nga hendeqet më të mëdha që ekzistojnë midis gjinive.

Sipas Indeksit të Barazisë Gjinore të publikuar nga INSTAT, kur bëhet fjalë për pushtet, gratë shqiptare listohen krahas atyre më të pushtetshme në Europë si Suedisë, Francës dhe Danimarkës, mbi normën mesatare të 28 vendeve të Bashkimit Europian. Nuk është aspak rastësi lidhja e grave shqiptare me pushtetin, mjafton të kujtojmë mbretëreshën ilire, Teutën, jehona e pushtetit të së cilës dëgjohet deri në ditët e sotme.

Fusha e pushtetit të gratë matet përmes tre nënndarjeve kryesore: pushteti politik, pushteti ekonomik dhe pushteti social.

Në politikë, pjesëmarrje gati sa dyfishi i grave europiane

Nënfishat e pushtetit politik përfshijnë tregues që matin raportin e grave me personat në cilësinë e ministrit të qeverisë dhe përqindjen e grave deputete në Parlamentin Kombëtar. Përveç kësaj, kjo nënfishë përfshin edhe treguesin e përfaqësimit të grave në pozicionet e përfaqësuesve në këshillat bashkiakë. Gratë marrin pjesë në pozicione ministrore në Shqipëri



GRATË NUK JANË, NUK KANË SESI TË JENË, THJESHT NJË NUMËR, DIÇKA MË SHUMË APO MË PAK SE GJYSMA E POPULLSISË. ATO LUAJNË ROLE KYÇE NË FORMËSIMIN E JETËS SONË. SHOQËRIA TRADICIONALE I SHEH ATO NË ROLIN E NËNËS, MËSUESES, GRUAS. POR PJESËMARRJA DHE KONTRIBUTI I TYRE, GJITHMONË E MË I NJOHUR, GJITHNJË E MË I FORMALIZUAR, SHTRIHET NË ÇDO PJESË TË JETËS. SA MË SHUMË TË BËHEN PREZENTE FEMRAT NË ROLET E ASHTUQUAJTURA JO-TRADICIONALE, AQ MË SHUMË IMPAKT KRIJOJNË, AQ MË SHUMË KREATIVITET, VLERË, PRAKTICITET DHE ENERGJI SJELLIN ATO.

me 45.4%, një shifër që është shumë më e lartë se sa 28.1% e mesatares së BE-28, sipas INSTAT. Po kështu, gratë janë më të përfaqësuara në këshillat bashkiakë të Shqipërisë se sa në BE (35.9% krahasuar me 28.5%).

Paraja është pushtet

Nënfisha e pushtetit ekonomik i referohet dallimit në menaxhimin e burimeve ekonomike përmes pozicioneve drejtuese dhe përfshin treguesit e pjesëmarrjes së grave në bordet menaxhuese ose mbikëqyrëse të kompanive më të mëdha në bursë dhe pjesëmarrjen në bordet ekzekutive të bankës qendrore. Megjithatë, ato janë disi më pak të përfaqësuara si deputete në parlament krahasuar me BE-28 (26.2 për qind krahasuar me 29.3 për qind).

Pjesëmarrja e grave në pozicione drejtuese të kompanive më të mëdha është paksa më e lartë në Shqipëri se sa në mesataren e BE-28 (26.4 për qind krahasuar me 25.0 për qind) dhe shumë

më e lartë kur vjen fjala tek anëtarësia e bordit të bankës qendrore (48.1 për qind krahasuar me 20.3 për qind).

Pushteti social i grave shqiptare

Nënfisha e pushtetit social përfshin treguesit që matin raportin e grave dhe burrave në bordet e organizatave që financojnë kërkimet shkencore, përqindjen në bordet e kompanive të transmetimit publik dhe përqindjen në anëtarësinë e organeve më të larta vendimmarrëse të organizatave kombëtare sportive olimpike.

Pushteti social mbulohet nga Indeksi i Barazisë Gjinore për shkak të ndikimit simbolik që ai ka tek shoqëria dhe aksesin në struktura dhe në pozicionet e pushtetshme në fusha të ndryshme.

Krahasuar me mesataren e 28 vendeve të BE-së, gratë në Shqipëri kanë një përfaqësim relativisht të lartë në bordet e organizatave që financojnë kërkimet shkencore krahasuar me

mesataren e BE-28 (44.4 për qind krahasuar me 39.9 për qind), por ato janë shumë pak të përfaqësuara në bordet e organizatave transmetuese publike (9.1 për qind krahasuar me 36.0 për qind) dhe në organet më të larta vendimmarrëse të organizatave kombëtare sportive olimpike (9.4 për qind krahasuar me 14.8 për qind).

"Bëni më të mirën që mundeni në çdo detyrë, pavarësisht se sa e parëndësishme mund të duket. Askush nuk mëson më shumë për një problem sesa personi që është në fund", - Sandra Day O'Connor, gruaja e parë e emëruar në Gjykatën Supreme.

"Çdo ditë bëni një gjë që ju frikëson", - Eleanor Roosevelt, Zonja e Parë në Shtetet e Bashkuara.

"Akti më i guximshëm është të mendoni për veten me zë të lartë", - Coco Chanel, dizajnere për modën.

"Mos mbani njerëz në jetën tuaj që ju bëjnë të ndiheni keq dhe besojuni instikëve tuaja. Marrëdhëniet e mira ju bëjnë të ndiheni mirë. Ato nuk ju lëndojnë. Kjo nuk është vetëm për dikë me të cilin dëshironi të martoheni, por është për miqtë që zgjidhni. Ka lidhje me të gjithë njerëzit që rrethoheni", - Michelle Obama, Zonja e Parë e Shteteve të Bashkuara.

"Dua që vajzat e vogla të rriten duke ditur se mund të bëjnë gjithçka, madje edhe të luajnë futboll", - Jen Welter, trajnerja e parë femër e NFL-së. "Ju mund t'i keni të gjitha. Vetëm se jo të gjitha në të njëjtën kohë", - Oprah Winfrey, personalitet televiziv.

Gra që frymëzojnë, gra që në forma të ndryshme bënë revolucion.



JANI VRETO
PETRO.NINI.LUARASI
FAN.S.NOLI
PAPA.KRISTO.NEGOVANI
GJERASIM.QIRIAZI
THEMISTOKLI.GERMENJI
SALL.BUTKA
GJERGJ.QIRIAZI
SEVASTI.QIRIAZI
KRISTO.LUARASI
PARASHQEVI.QIRIAZI
NAUM.CERJA
THANAS.SINA
ABDYL.YPI
HAKI.GLINA
XHEMAL.GOROSHIANI

QANI.YPI
TELEMAK.GERMENJI
ZALO.PRODANI
BABA.BRAHO.QESAR
LIGOR.MARKO.BORO
ZIHN.LESKOVIKU
GANI.BUTKA
HASAN.QINAMI
PETRAQ.KITA
ASLLAN.METKA
BALIL.TAHIRI
MERSIN.PRODANI
SOTIR.SHTIKA
STEFAN.IKONOMI
NIKOLLA.IKONOMI
VASIL.NDREKO.POST
ILJAZ.KOLONJA

'Burrat e mëdhenj nuk i munguan as dje Shqipërisë, as sot dhe nuk do t'i mungojnë as nesër'

"Më gjeni një krahinë, sa e si Kolonja, me bukuri natyrore përrallore e që në altarin e mendjes e patriotizmit, të ketë dhënë kaq emra e mendje të ndritura!", - do të shkruante një penë e ndritur e gazetarisë, i cili solli emra të panteonit të krenarisë shqiptare, profesionalisht si bir i kësaj krahine, zoti Muharem Meko me detyrën për t'i sjellë brezit të ri, pjesën më të lavdishme të historisë shqiptare, për të cilën duhet të jenë krenarë kudo ku janë.

Jani Vreto

Në vjeshtën e vitit 1877 u bë anëtar themelues i Komitetit qendror për mbrojtjen e të drejtave të kombësisë shqiptare dhe punoi aktivisht për përmbushjen e qëllimeve të tij. Në maj 1878, pas daljes së një radhe artikujsh polemik në shtypin grek, sidomos në gazetën "Neologos", Vretoja botoi veprën "Apologia", Kostandinopojë 1878, në greqishte, në të cilën shtjellon prejardhjen e shqiptarëve, gjuhën, trevat e banuara



prej tyre e të drejtat e tyre. Në fillim të vitit 1879 u caktua anëtar i komisionit të ngritur nga Komiteti qendror për të vendosur për alfabetin përfundimtar të shqipes. Anëtarët e këtij komisioni prej kohësh kishin mendime të ndryshme e nuk pajtoheshin në këtë çështje shqetësuese të alfabetit, gjë për të cilën Vretoja ishte për alfabetin grek.

Më 12 tetor 1879 mori pjesë në themelimin e Shoqërisë e të shtypurit shkronja shqip, e cila do t'ia kushtonte energjitë e veta botimit të librave shqip, sidomos të teksteve shkollore, si dhe hapjes së shkollave në gjuhën shqipe. Vretoja qe autor i një statuti (Kanonizmë) të shoqërisë, së cilës i ra barra të reagoje me zgjuarsi e në mënyrë diplomatike ndaj kundërshtimeve Osmane e, sidomos, ndaj qëndrimeve armiqësore greke për çështjen e zgjimit kulturor shqiptar. Pikërisht në këtë kohë ai u shkikërua nga mitropoli ortodoks i Gjirokastrës, sepse paskësh bëre herezi "duke krijuar një çështje shqiptare". Në verë të vitit 1881, Vretoja shkoi në Bukuresht që të zgjonte interesimin për lëvizjen kombëtare ndër shumë shqiptarë që ishin ngulur me banim aty e nëpër Rumani, dhe themeloi në Bukuresht një seksion të Shoqërisë së të shtypurit shkronja shqip. Pas kthimit në Stamboll, Vretoja punoi me energji për botimin e organit periodik "Drita", që më pas mori emrin "Dituria", e cila doli në Kostandinopojë nga gushti 1884 deri në korrik 1885. Në dhjetor 1884 ai bashkëpunoi për themelimin e shoqërisë "Drita" të Bukureshtit dhe shërbeu si sekretar i saj, duke bërë praktikisht gjithçka në shtypshkronjë.

Ndërroi jetë në korrikun e vitit 1900 në Athinë.

I ndikuar nga kultura helene që në kohën e studimeve në Zosimea (gjë për të cilën Konica do ta quante grekoman), ai hartoi një vjershë më 1847 për Skënderbeun me alfabet grek dhe nisi të mblodhë fjalë të urta e këngë popullore shqiptare. Botimi i parë i Vretos ishte një gramatikë e greqishtes e përkthyer shqip, "Grammatikë tës omilumenës hellënikës glóssës eis tën albanikën", Kostandinopojë 1866 (Gramatikë e greqishtes së folur në gjuhën shqipe). Me shoqërinë "Drita" të Bukureshtit u botuan dy libra të Vretos: "Mirëvetija" dhe "Numeratoreja" më 1886. Një vit më pas ai botoi një vepër 158 faqesh me titull "Radhuashkronjë", Bukuresht 1889 (Llogaritje), për tregtarët dhe biznesmenët shqiptarë në Rumani.

Më 1888 përshtati veprën "Erveheja" të Muhamet Kyçyikut me alfabetin e Stambollit dhe e purifikoi me njëfarë mase nga orientalizmat - sipas Elsie varianti i Vretos rreket ta paraqesë veprën në një formë më epike me epitetet përkatëse.

Presidenti i Shqipërisë, Bamir Topi, më 13 janar 2012, i akordoi Jani Vretos (pas vdekjes) Urdhrin "Nderi i Kombit" me motivacionin: "Figurë e shquar e kombit, një nga veprimtarët e ndritur të Rilindjes, që çështjen kombëtare e pa të lidhur njësh me krijimin dhe zhvillimin e arsimit kombëtar dhe përpjekjet për krijimin e alfabetit shqiptar dhe

botimin e abetares së parë shqipe i konsideronte si beteja të mëdha për fitoren e pavarësisë dhe krijimin e shtetit shqiptar."

Petro Nini Luarasi

Pasi mbaroi shkollën e seminarit të Qestoratit punoi si mësues në fshatrat e rrethit të Kolonjës, ku mësoi shqip i maskuar dhe përgatiti një numër shokësh si mësues të ardhshëm të shqipes. Në vitin 1887 Luarasi dhe shoku i tij mësues Thanas Sina morën drejtimin e shkollës shqipe në Korçë nga Pandeli Sotiri pas largimit të tij. Mes viteve 1887 dhe 1893 Luarasi hapi në Ersekë dhe në disa fshatra të rrethit të Kolonjës shkolla në gjuhën shqipe. Themelimi dhe promovimi i shkollave shqipe nga Luarasi në zonën e Kolonjës e solli atë në konflikt me Filaretos, kryepeshkopin grek të Kosturit. Në vitin 1892 një letër qarkore iu dërgua popullatës shqiptare ortodokse të Kolonjës për të shkëputur



lidhjet mes tyre dhe Luarasi me Filaretos, duke iu referuar atij si një “renegat i mallkuar” që përhapte “masonerinë dhe protestantizmin e lirë”, ndërsa dënonte punën e tij me shkollën shqipe dhe thoshte se Gjuha shqipe “nuk ekzistonte”.

Më pas emigroi në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në periudhën 1904 - 1908, ku ishte anëtar aktiv i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare dhe nismëtar i shoqatave patriotike “Malli i Mëmëdheut” dhe “Pellazgu”. Luarasi punoi gjithashtu si drejtor dhe mësues i Shkollës së parë shqipe të motrave Qiriazit në Korçë dhe në vitet 1909-1911 punoi si drejtor i shkollës së Negovanit, të themeluar nga Papa Kristo Negovani.

Ai gjithashtu ka kontribuar në organizatat për rrugën që çon në Shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë (shkëputja) nga Perandoria Osmane.

Luarasi mori pjesë në Kongresin e Manastirit që sanksionoi krijimin e alfabetit të shqipes në vitin 1908. Për veprat e tij patriotike, shkëputjen e Shqipërisë nga Perandoria Osmane, mësimin e gjuhës shqipe dhe veprimtarinë shoqërore, ai u persekutua nga Patriarku Ekumenik i Kostandinopojës dhe regjimi i turqve të rinj. Sipas shumë mundësive ai vdiq i helmuar nga Patriarkana, më 17 gusht 1911.

Presidenti i Shqipërisë, Bamir Topi, më 13 janar 2012, i akordoi Petro Nini Luarasi (pas vdekjes) Urdhrin “Nderi i Kombit” me motivacionin: “Figurë e shquar e kombit, një nga veprimtarët e ndritur të Rilindjes Kombëtare, luftëtar i paepur për zgjimin, emancipimin dhe prosperimin e kombit shqiptar, për çlirimin nga zgjedha osmane dhe formimin e shtetit komb të shqiptarëve, luftëtarit të madh të krijimit të arsimit kombëtar si një nga shtyllat e çështjes kombëtare, vepër për të cilën dha edhe jetën.”



Fan Stilian Noli

Fan Noli ka qenë dramaturg, klerik ortodoks, politikan, diplomat, njeri i letrave dhe muzikant.

Si njeri i letrave, Noli ka shkruar dhe ka përkthyer tekste të shumëllojshme nga zhanre të ndryshme, si dhe ka kontribuar në publicistikën e kohës si drejtues, redaktor dhe shkruar nëpër disa të përkohshmeve. Nisi duke përkthyer dramaturgj, më pas përktheu Samiun, tekste fetare ortodokse dhe vepra madhore të letërsisë botërore nga Shekspiri, Khajami dhe Servantesi.

U regjistrua në Universitetin e Harvardit, duke e përfunduar më 1912, “Bachelor of Arts”. Zuri vendin e Pecit si redaktor i “Kombit”, detyrë që e kreu deri në janar të 1909. Një muaj më vonë, nisi të botojë e drejtojë fletoren “Dielli”, zëdhënëse e bashkësisë shqiptare të Bostonit. Pas shkërrijës së shoqatave të shqiptarëve të Amerikës, “Dielli” u bë organi i shtypit i shoqërisë pashqiptare Vatra, bashkëthemelues i të cilës qe edhe Noli me Konicën.

Në pragun e Luftës Ballkanike, Noli shprehej me luajalizëm kundrejt perandorisë që të mund të bënte qëndresë kundrejt armiqve. Me shpalljen e pavarësisë e përkrahu qeverinë e Ismail Qemalit, mori pjesë në Kongresin e Triestes, organizuar nga Konica në marsin e 1913. Më 10 mars 1914 u ndodh në Durrës, ku e gjeti Lufta e Parë Botërore; më 24 maj 1915 u kthye në Amerikë.

Nga 21 dhjetori 1915 deri më 6 korrik 1916, u bë përsëri kryeredaktor i “Diellit” të Bostonit, tashmë gazetë e përditshme. Në korrik 1917 u bë edhe një herë kryetar i Federatës “Vatra”. Në shtator të vitit 1918 Noli drejtoi organin “The Adriatic Review” (Revista e Adriatikut) gjashtë muajt e parë të saj, të cilën e botonte si shtojcë “Dielli” i Vatrës.

Më 24 mars 1918, u caktua administrator i Kishës Ortodokse Shqiptare në Shtetet e Bashkuara dhe në fillim të korrikut të atij viti mori pjesë në një konferencë për popujt e shtypur në Mount Vernon, Virxhinia, ku u takua me presidentin Udrou Uillson, përkrahës i të drejtave të pakicave në Evropë. Më 27 korrik 1919 u emërua peshkop i Kishës Ortodokse Shqiptare në Amerikë, që tashmë ishte dioqezë e pavarur. Një vit më pas u zgjodh kryetar i delegacionit shqiptar në Lidhjen e Kombeve në Gjenevë, ku arriti ta anëtarësonte Shqipërinë më 17 dhjetor 1920.

Jeta Parlamentare

Me zgjedhjet e mbajtura më 5 prill 1921, zgjidhet deputet i Kolonisë së Amerikës në legjislaturën e dytë (21 prill 1921 - 30 shtator 1923).

Ai shërbeu si ministër i Jashtëm në qeverinë e Xhaferr Ypit, vetëm për pak kohë përpara se të dorëhiqej. Noli ishte kryetar i Partisë Popullore, e majta e asaj kohe, kundrejt Partisë Përparimtare.

Përkrah Luigj Gurakuqit dhe Stavro Vinjaut është ndër oratorët më shpotitës të foltores parlamentare.

Më 21 nëntor 1923, u shugurua peshkop i Korçës dhe mitropolit i Durrësit në Durrës, ndërsa më 27 dhjetor 1923 u zgjodh deputet i Korçës.

Ndryshe ajo njihet dhe si paraaja e njëmijë e një burimeve, ku ndërthuret bukur peizazhi natyror me bimësinë që gjendet përgjatë burimeve ujore.

Këlcyra është qytet në Shqipërinë jugore, pjesë e qarkut Gjirokastrë. Ajo shtrihet mes maleve

Trebeshinë dhe Nemërçkë dhe laget nga lumenjtë Vjosë dhe Dishnicë.

Territori i bashkisë shtrihet në pjesën juglindore të vendit tonë dhe kufizohet në veri me bashkinë Skrapar, në jug me bashkinë Përmet dhe Libohovë dhe në perëndim me bashkinë Tepelenë.

Qendra e bashkisë është qyteti i Këlcyrës, të cilit i bashkohen Ballabani, Suka dhe Dishnica. Gjithsej, bashkia ka nën administrimin e saj një qytet dhe 49 fshatra. Njësitë administrative rurale karakterizohen nga një numër shumë i lartë i fshatrave që grupojnë, numër ky që varion në 14-15. Qyteti i Këlcyrës gjithashtu përfshin 5 fshatra.

Udha për në Këlcyrë, pasi shkëputet nga rruga Tepelenë-Gjirokastrë, lë në të djathtë rrënojat e qytetit të lashtë të Antigonesë, hyn në grykën madhështore e të mirënjohur të Këlcyrës, në kohët e moçme Fauces Antigonenses, prej ku Filipi V i Maqedonisë u preu rrugën romakëve të Flaminit për në Greqi, çan mes honesh të thepisura dhe mbërrin në pikën më të lartë të pllajës që shtrihet mes Malit të Trebeshinës e Nemërçkës në qytetin e Këlcyrës, i vendosur në të djathtë të Vjosës, aty ku lumi i Dishnicës së bashku me degët e veta nis bashkërrjedhjen me Vjosën.

Këlcyra përmendet në një kronikë mesjetare të vitit 1272 me emrin latin Clausura.

Këlcyra në lashtësi duhet të ketë pasur funksionin e një mansonit, stacion ku ushtarët romak kalonin natën me një garnizon që mbronte kalimin prej Adriatikut drejt Maqedonisë, gjurmët e të cilave u shkelën nga rrugët e mëvonshme osmane.

Gjurmët e Këlcyrës humbasin në tymtajën e shekujve dhe qyteti del përsëri në dritë si pronë e Muzakajve, Andrea Muzakës, zot i Beratit dhe Marshall i Arbërisë (1280-1319). Me vdekjen e Andreas I, trashëgimia i kaloi djalit të tij, Teodorit I, që la dy djem, më i vogli i të cilëve, Mentuli ose Mentori mbante titullin e Kontit të Klisanisë.



Nivica



Këlcyrë

Shkenca prapa teknologjisë së fshehtë në avionët ushtarakë

Ardhja e avionëve ushtarakë ka qenë ndoshta tipari më përcaktues i luftës moderne. Që kur u prezantuan gjatë Luftës së Parë Botërore, avionët ushtarakë kanë mbështetur forcat tokësore në mënyra të paparamenduara të mundshme për mijëra vjet të historisë njerëzore përpara asaj ngjarjeje. Që atëherë, teknologjia ka përparuar me shpejtësi, me qeveritë që derdhen burime për të siguruar që avionët e tyre të jenë më të mirë se ata të kundërshtarëve të tyre.

Aeroplanët në Luftën e Parë Botërore fillimisht u përdorën vetëm për zbulim, megjithëse u pajisën shpejt me armë dhe që atëherë kanë qenë armë taktike sulmuese. Teknologjia vazhdoi t'i bënte avionët armë më të fuqishme dhe më efektive, por futja e radarit në Luftën e Dytë Botërore e bëri përdorimin e avionëve sulmues menjëherë më të pasigurt.

Lufta e Ftohtë vendosi një fokus lazer në krijimin e avionëve që mund të hynin në hapësirën ajrore të armikut të pazbuluar, qoftë për zbulim, bombardime ose sulme të drejtpërdrejta përpara. Kjo çoi në shfaqjen e një sërë teknologjish, por një prej tyre tani është zbatuar gjerësisht me rezultate të suksesshme. Duke përdorur një kombinim të teknologjive themelore në procesin e prodhimit të avionëve ushtarakë, avionët modernë ushtarakë mund të jenë kryesisht të pazbulueshëm për radarët. Kjo quhet teknologji e fshehtë, dhe këtu, do të shohim se si funksionon në të vërtetë shkenca pas saj.

Lufta e Dytë Botërore ishte një kohë e inovacionit të shpejtë. Me nevojën për t'u mbrojtur kundër një armiku të frikshëm dhe për të eliminuar kërcënimin e paraqitur prej tij, forcat aleate punuan gjatë gjithë kohës për të zhvilluar shkencën që mund të shndërrohej në teknologji për të ndihmuar përpjekjet e luftës. Një nga zhvillimet më të rëndësishme ishte radari, i cili si emër përdor një akronim për zbulimin dhe rangun e radios.

Hulumtimi në valët e radios të përdorura për krijimin e radarëve filloi në fund të viteve 1800, por një nga aplikimet e para për gjetjen e avionëve zyrtarisht doli në internet në vitin 1940 për të siguruar brigjet e Britanisë. Duke transmetuar valë radio në atmosferë dhe duke dëgjuar me një marrës që ato valë të kthehen pas hedhjes së objekteve në qiell, operatorët mund të përcaktonin vendndodhjen e avionëve armik dhe me çfarë shpejtësie ata po udhëtonin. Me këtë mjet, britanikët mund të zbulonin skuadriljet gjermane në hyrje deri në 75 milje larg, duke ndryshuar rezultatit e angazhimeve të hershme në luftë, veçanërisht në Betejën e Britanisë.

Pavarësisht arritjeve teknologjike të aleatëve, gjermanët kishin zhvilluar sistemin e tyre të quajtur njëkohësisht "Freya", duke e vendosur për herë të parë në 1938 dhe duke çuar në një lojë macja-miu për përmirësimin e teknologjisë që vazhdoi gjatë pjesës tjetër të luftës. Konkurrenca midis Boshut dhe Aleatëve përfundoi në vitin 1945, por Lufta e Ftohtë në zhvillim nënkuptonte që rivaliteti teknologjik do të vazhdonte të ishte një pjesë e spikatur e geopolitikës deri në ditët e sotme. Radari përdoret ende sot, dhe megjithëse është shumë më i avancuar dhe më i aftë se sa ishte në vitin 1940, bazat e teknologjisë mbeten të njëjta.

Si u identifikua nevoja për fshehtësi

Me pak angazhime të drejtpërdrejta midis



SR-71 Blackbird

Bashkimit Sovjetik dhe Shteteve të Bashkuara gjatë periudhës së Luftës së Ftohtë, zbulimi u bë një përparësi kryesore për zyrtarët e mbrojtjes. Shtetet e Bashkuara zhvilluan aeroplanin spiun U-2 me aftësinë për të fluturuar mbi Bashkimin Sovjetik pa u zbuluar, por ai mbështetej në një tavan jashtëzakonisht të lartë fluturimi për të operuar përtej rrezes së radarit dhe jo teknologjinë e vërtetë të fshehtë. Krijimi i avionëve të pazbuluar nga radarët vazhdoi të ishte një pjesë thelbësore e kërkimit dhe inxhinierisë së avionëve, duke nxitur përpjekjet të bashkërenduara për të gjetur zgjidhje nga shkencëtarët dhe inxhinierët në vende të tilla si divizioni "Skunk Works" i "Lockheed". Avioni spiun U-2 fluturoi për herë të parë në mesin e viteve



'50, duke siguruar fotografi të rëndësishme të lëvizjeve dhe instalimeve ushtarake në Bashkimin Sovjetik.

Megjithatë, fluturimet mbi territorin sovjetik përfunduan kur "Gary Powers" u rrëzua në vitin 1960. Agjentët sovjetikë kishin depërtuar në programin U-2 dhe kishin transmetuar informacionin e fluturimit te KGB-ja, duke i bërë sovjetikët në hijen e "Powers" me luftëtarët MiG që ndihmuar në drejtimin e një sulmi të suksesshëm SAM kundër Fuqive. Kjo bëri që Agjencia Qendrore e Inteligjencës të mbështetej në "Lockheed" për të zhvilluar një lloj të ri avioni me një seksion kryq radar (RCS) të reduktuar ndjeshëm.

Zhvillimi i Teknologjisë "Stealth" (fshehtësi)

Ndërsa U-2 përdori lartësinë për të shmangur zbulimin, ai nuk është në asnjë mënyrë një avion i fshehtë. Teknologjitë e para të zhvilluara për të reduktuar zbulimin e radarëve ishin veshjet dhe mbulesat që thithnin radarin, dhe modeli i parë që mori teknologji "Stealth" ishte "Lockheed" A-12 i fluturuar nga CIA dhe u zhvillua përfundimisht në SR-71 "Blackbird" të Forcave Ajrore amerikane. Ai ndoqi gjurmët e U-2 duke pasur një tavan shërbimi prej 25908m dhe, ndoshta më e rëndësishmja, një shpejtësi maksimale prej 4042.6 km/orë, duke e bërë atë avionin më të shpejtë të fluturuar ndonjëherë.

SR-71 njihet menjëherë nga forma e tij dalluese dhe fundi i zi mat. Teknologjia "Stealth" e inkorporuar në kornizën e tij të ajrit përfshin materiale të përbëra për finë e bishtit dhe skajet e përparme, formën e saj të veçantë dhe bojën e zezë të mbushur me grimca ferriti për të ndihmuar në thithjen e radarit. Për më tepër, karburanti i avionit JP-7 i përdorur në këtë avion ishte i lidhur me cezium, duke krijuar një re plazme për të reduktuar më tej RCS-në e saj dhe për të fshehur shtëllungën e madhe të shkarkimit nga motorët.

kurrë aq të vegjël sa një pëllumb në radar.

Forma, materialet, motorët dhe pajisjet duhet të projektohen të gjitha së bashku me një fokus të vetëm të sinjaleve të radarit shpërndarës larg avionit. Një trup i rrumbullakët do të pasqyrojë sinjalet e radarit nga çdo pikë mbi harkun e kurbës, duke siguruar zbulimin. Për të shmangur këtë, sipërfaqet e sheshta dhe rruhat e mprehta përdoren për të reflektuar qëllimisht atë sinjal në një drejtim tjetër, në mënyrë që të mos kthehet përsëri te marrësi i tij. Kjo është ajo që çoi në formën e çuditshme këndore të F-117 "Nighthawk", avioni i parë luftarak i vërtetë i "Stealth" i Forcave Ajrore të SHBA-së.

Për ta bërë avionin të padukshëm për radarin,



ai përdor pothuajse të gjitha sipërfaqet e sheshta dhe arsyeya pse forma e tij është kaq e veçantë është se kompjuterët e avancuar të përdorur sot për të projektuar aeroplanët modernë të fshehtë nuk ekzistojnë. F-117 është teknologjia më e mirë që mund të bënte në vitet 1970. Me avionët e njëpasnjëshëm, dizajni i avancuar me ndihmën e kompjuterit i ka lejuar inxhinierët të krijojnë aeroplanë me pamje më konvencionale që mbajnë RCS të vogla, megjithëse ato ende përdorin sipërfaqe të sheshta shumë më tepër sesa kornizat e avionit jo të fshehtë.

Avionët që përdorin teknologjinë e fshehtësisë

Lista e avionëve që po projektoshin me aftësi të plota "Stealth" filloi me F-117 "Nighthawk" dhe vazhdoi me B-2 "Spirit", F-22 "Raptor" dhe F-35 "Joint Strike Fighter". Një atribut i përbashkët i të gjithë këtyre avionëve është mungesa e një stabilizuesi vertikal dhe timoni.

Dizajni i avionëve të fshehtë heq me kujdes çdo sipërfaqe të prirur për zbulimin e radarit, duke përfshirë hyrjet e motorit ose sipërfaqet e pjesëve ngjitur me kënde të drejta. Kjo është arsyeja pse stabilizuesit e dyfishtë vendosen në kënde agresive dhe hyrjet e motorit nuk janë kurrë vrime uniforme drejtkëndëshe ose rrethore. Çdo rrudhë në një kornizë ajrore llogaritet me kujdes për të shpërndarë sinjalet e radarit. Rezultati është se RCS i F-35, për shembull, e bën atë të duket jo më i madh se 0,005 m², vetëm pak më i madh se një kolibër.

Avionët amerikanë nuk janë të vetmit luftëtarë "Stealth" në qiell, edhe pse ata dominojnë në fushë. Teknologjia sovjetike ka mbetur shumë prapa Perëndimit, duke e lënë Rusinë pa një aeroplan të tillë deri në vitin 2019. Edhe atëherë, Su-57 e tij zbehet në krahasim me teknologjinë perëndimore pasi RCS e tij është rreth 1000 herë më i madh se F-35 në diku midis 0.1 dhe 1.0 m².

Për më tepër, Rusia ka më pak se 20 avionë luftarakë "Stealth" të ndërtuar me dorë në flotën e saj, ndërsa SHBA-ja ka prodhuar tashmë qindra avionë F-35. Një Su-75 "Checkmate" i planifikuar ende nuk është futur në prodhim. Ndërsa Kina ka prodhuar

luftëtarin e saj të fshehtë "Chengdu" J-20 në numër të moderuar.

Sukseset dhe dështimet e avionëve të fshehtë

SR-71 fluturoi dhjetëra fluturime mbi Vietnam gjatë shërbimit të tij, megjithëse ka të ngjarë të ketë përdorur shpejtësinë e tij ekstreme më shumë se aftësitë e fshehta për t'u shmangur kundërshtarëve të tij.

Përdorimi i radhës i një luftëtarit të fshehtë ishte angazhimi i F-117 "Nighthawk". Avioni u vendos për herë të parë në Panama në vitin 1989, duke hedhur bomba pranë kazermave të forcave mbrojtëse për të lehtësuar dorëzimin. Megjithatë, ishte në Irak gjatë "Stuhisë së Shkretëtirës", ku "Nighthawk" provoi aftësitë e tij, duke kaluar me shpejtësi mbrojtjen e Irakut dhe duke çuar në dërrmimin e forcave irakiane. F-117-të përsëri panë veprime mbi Ballkan gjatë shpërbërjes së Jugosllavisë, por radari serb zbuloi një F-117 në ajër me dyert e tij të armëve të hapura dhe lëshoi një raketë tokë-ajër, duke goditur avionin "Nighthawk" dhe duke rrëzuar.

B-2 "Spirits" fluturuan shumë misione mbi Irak, ndërsa F-22 më vonë shërbyen në objektivat e ISIS-it. Sot, F-35 "Joint Strike Fighter" është luftarak premierë me shumë funksione në degë të shumta të Ushtresë Amerikane dhe është në shërbim në skuadriljet e shumë vendeve anëtare të NATO-s. Megjithëse Rusia duhet të ketë një mundësi për të përdorur Su-57 të fshehtë në fushatën e saj kundër Ukrainës, raportet për misione të suksesshme janë të pakta.

Aplikacione të tjera të teknologjisë së fshehtë

Megjithëse teknologjia e fshehtë u zhvillua për avionë, ajo nuk kufizohet vetëm në avionë luftarakë dhe bombardues. Zhvillimi më i fundit i konstruksionit të fshehtë është shfaqur në grupin e zgjeruar të mjeteve ajrore pa pilot, shpesh të referuara si dronë. Lista e UAV-ve që përdorin teknologjinë e fshehtë nuk është aq e thjeshtë për t'u prodhuar. Shtetet e Bashkuara kanë zhvilluar RQ-180 dhe XQ-58A "Valkyrie", të cilat të dyja janë vënë në shërbim. Për më tepër, shumë kompani të tjera globalisht kanë hyrë në biznesin e UAV-ve, dhe shumë prej tyre mund të ndërtohen duke përdorur elemente të fshehtë. Kompania "Baykar" e Turqisë ka premtuar shumë me suksesin e produkteve të saj në Ukrainë.

Një fushë tjetër që përfiton nga konstruksioni i fshehtë është prodhimi i armëve. Raketat e lundrimit të pazbulueshme nga radarët përbëjnë një kërcënim të rëndësishëm për kundërshtarët që nuk janë në gjendje t'i gjurmojnë ato me sisteme të avancuara paralajmëruese. Një shembull i tillë është "Storm Shadow" i prodhuar së bashku nga Franca dhe Britania e Madhe, i cili përdor teknologjinë e fshehtë së bashku me një lartësi të ulët lundrimi për të shmangur zbulimin. Këto kohë e fundit i janë dhënë Ukrainës për mbrojtjen e saj dhe janë përdorur me sukses kundër forcave që pushtojnë territorin e saj.

Përveç kësaj, një tjetër adaptim i kohëve të fundit i teknologjisë aero-stealth ka qenë në armët detare dhe ndërtimin e anijeve të fshehta, duke bërë që një varkë me armë apo edhe një shkatërrues të duket në radar se nuk është më shumë se një varkë e vogël peshkimi.

E ardhmja e teknologjisë së fshehtë

Ndërtimi i avionëve të fshehtë në këtë pikë duhet të jetë zona e dukshme e rritjes për aviacionin ushtarak krahas inovacionit në automjetet pa pilot dhe teknologjinë e armëve. Këto gjëra tashmë janë zbatuar dhe të tjera do të jenë në rrugë e sipër. Megjithatë, me aftësitë e reja sulmuese që vijnë në internet, ministritë e zellshme të mbrojtjes do të kërkojnë gjeneratën e ardhshme të sistemeve të paralajmërimit të hershëm dhe radarët mund të zëvendësohen nga diçka edhe më e fuqishme.

Shtetet e Bashkuara tashmë po ndërtojnë bombarduesit e tyre të gjeneratës së ardhshme për të zëvendësuar B-2 "Spirit", B-21 "Raider". Rusia ka shfaqur gjeneratën e ardhshme të avionëve të fshehtë luftarakë Su-754, por mungesa e prototipave fluturues e bën prodhimin e tyre serial të dyshimtë, veçanërisht me cilësinë e dobët të Su-57 ekzistuese. Zhvillimet më të mëdha të teknologjisë së fshehtë ka të ngjarë të ndodhin njëkohësisht në të gjithë botën, me luftëtarë të avancuar në zhvillim në Turqi, Indi, Korenë e Jugut dhe gjatë. Askush nuk e di se çfarë ka e ardhmja, por zhvillimi i vazhdueshëm i avionëve të fshehtë sigurisht që do të luajë një rol të jashtëzakonshëm në të.

Testimi i besnikërisë dhe mirënjohjes

NGA KLAUDIA MALAJ

Letërsia angleze njihet për pasurinë e paçmueshme në figuracione letrare, përmes të cilave ka përcjellë breza e breza ndër shekuj shkrimet, tregimet, dramat dhe rrëfenjat e saj. Të gjithë ne kemi lexuar të paktën një nga kryeveprat e Shekspirit, apo George Orwellit. Ajo që bën diferencën është shkrimi i thjeshtë i autorëve anglezë, i kuptueshëm dhe i bazuar në përditshmërinë tonë. Ndaj letërsia angleze mbetet si një nga “rrëfenjat” më memorizuese për cilindo. Sjellja bukur e historive të bazuara në realitet, ka bërë të mundur edukimin me mesazhe motivuese. Edhe në kohë lufte qeniet humane jetojnë me çdo qelizë të trupit të tyre dashurinë njerëzore, besnikërinë dhe mirënjohjen, vlerë e paçmuar e njeriut.

Po çfarë ndodh, kur në fushëbeteje mes lumenjsh gjaku dhe armën në krah, në përhumbeje ëndrrash të lodhura, të rinjtë në frontin e luftës, luftojnë duke menduar se nuk jetojnë vetëm për vete por dhe për dikë që e pret me letër malli mes duarsh?!

Gjatë Luftës së Dytë Botërore, ushtarët britanikë, të cilët ndodheshin në frontin e luftës, ndiheshin të rraskapitur, me moral të rënë dhe u mungonte vullneti për të vazhduar betejën, madje edhe të shkëlqin mbi betimin e tyre “Japim jetën për atdhe”. Kjo për shkak se “bota” i kishte sytë nga një superfuqi si Britania e Madhe.

Shumë prej tyre ndiheshin të pashpresë, të lodhur dhe të demotivuar mendërisht, saqë ishin të gatshëm edhe të vdisnin, vetëm të mos luftonin më. Një nga gjeneralët e luftës, duke menduar mbi një stimulim, i erdhi në mendje një ide interesante. Ai mendoi që çdo ushtar ta lidhë me korrespondencë me një femër. Kështu, ai u kërkoi vajzave angleze që të lidhen me një nga ushtarët në frontin e luftës, që t’u shkruanin dhe t’u jepnin kurajë.

Si gjithë ushtarët e tjerë, edhe personazhi i kësaj historie lidhet me një vajzë dhe kishte me të korrespondencë të rregullt.

Edhe pse nuk ishin parë asnjëherë, lidhjet e tyre u forcuan, saqë tashmë filluan të lidhen edhe emocionalisht me njëri-tjetrin. Ndërsa lufta ishte drejt mbarimit, personazhi ynë i shkruan të “dashurës” së tij se do të kthehej së shpejti në Londër dhe se dëshironte të martohej me të.

Vajza, inteligjente, nga ana tjetër, që dinte arsyet e këtyre korrespondencave i shkroi se akoma nuk ishin parë dhe nuk ishin pëlqyer fizikisht. Megjithatë, ushtari i shkruan gjithë mirënjohje dhe besnikëri se ajo e kishte shpëtuar nga “vdekja e sigurt”, me inkurajimet dhe ngritjen e moralit.

Duke parë vendosmërinë e tij, vajza i shkroi: “Kam frikë se kur të më shohësh nuk do më pëlqesh. Prandaj, unë do të pres tek stacioni i trenit dhe në xhepin tim të majtë do të mbaj një trëndafil të kuq. Nëse të pëlqen pamja ime, qëndro dhe më fol, në të kundërt largohu pa më folur, që mos të më thyesh zemrën më shumë.” Sa më shumë që treni afrohet me stacionin ku do të zbriste, zemra e ushtarit tonë e shtonte ritmin e rrahjes.

Vallë si do të ishte ajo që i kishte dhënë



PO ÇFARË NDODH, KUR NË FUSHËBETEJE MES LUMENJSH GJAKU DHE ARMËN NË KRAH, NË PËRHUMBJE ËNDRRASH TË LODHURA, TË RINJTË NË FRONTIN E LUFTËS, LUFTOJNË DUKE MENDUAR SE NUK JETOJNË VETËM PËR VETE POR DHE PËR DIKË QË E PRET ME LETËR MALLI MES DUARSH?!

zemër dhe inkurajuar? A do të ishte e bukur siç shpresonte, apo e shëmtuar?

Me të zbritur nga treni, ai u përball me një vajzë që mbante një trëndafil në xhepin e majtë të xhakëtës. Ai mbeti i përhumur për një farë kohe, pasi vajza që shihte ishte vajza më e shëmtuar që kishte parë në gjithë jetën e tij. Vajza që kishte përballë, nuk kishte asgjë të përbashkët me atë që ai kishte imagjinuar gjatë gjithë atyre viteve

korrespondence.

Kjo e bëri që ta injorojë atë dhe menjëherë u nis për në shtëpi. Pasi kishte bërë disa hapa, u ndal dhe mendoi me vete:

“Ku është besnikëria dhe mirënjohja për atë që i kishte qëndruar pranë? Që e kishte inkurajuar dhe i kishte dhënë zemër? Vërtet që qenka shumë e shëmtuar, por ajo më shpëtoi jetën.”

Në fund, ai vendosi që të jetë besnik dhe

mirënjohës me atë që e kishte shpëtuar nga “vdekja e sigurt.” Kështu, ai kthehet, qëndron para vajzës dhe i thotë:

- Unë jam personi të cilin po pret. - Vajza i buzëqeshi dhe ia ktheu:

- Por, unë nuk jam ajo që po kërkon ti. Vajza që kërkon ti është ajo vajza e bukur atje, është ajo që ma dha trëndafilin ta mbaj në xhep, që të testojë nëse je besnik dhe mirënjohës apo jo!



Dështimi i strategjisë ushtarake të Hitlerit në Lindje (Qershor 1941 - dhjetor 1941)



Përgatitur dhe përshtatur
nga SAKIP CAMI

STRATEGJIA SOVJETIKE E MBROJTJES AKTIVE

(Sipas studimit të Kolonelit sovjetik M. Tolcionov,
pjesëmarrës në këto luftime)

Ushtria sovjetike në këto luftime ndoqi strategjinë e mbrojtjes aktive për vetë faktin se bënte një luftë mbrojtëse në tokën e vet që e njëjtte shumë mirë dhe me mbështetjen e popullit të vet nga e cila kishte dalë.

Ndërsa ushtria gjermane nga ana e saj e drejtuar nga Hitleri zhvillonte një luftë jashtë kufijve të vendit të tij, një luftë të pamotivuar.

Klika hitleriane, që nga dita që mori fuqinë në dorë, filloi të ndërtojë makinerinë e fuqishme ushtarake për një luftë të madhe dhe për të sunduar popujt e tjerë pa motive e qëllime demokratike.

Industria e përparuar gjermane u kthye dhe u përdor krejtësisht për prodhimin e armëve e municioneve.

Nazistët dhe fashistët edukuan një brez të tërë me frymën e ekzekutimit të verbër dhe inkoshient të planeve kriminale e pushtuese të krerëve të tyre, krijuan një ushtri të fortë dhe të madhe, pa pikë nderi e dinjiteti njerëzor.

Lufta e shpërthyer nga hitlerianët filloi në mënyrë të favorshme për Gjermaninë naziste. Nën sulmet dërrmuese të ushtarëve e teknikës tepër moderne për kohën, u shpartalluan njëra pas tjetrës ushtritë e Polonisë, Norvegjisë, Holandës, Belgjikës, Jugosllavisë e Greqisë. Edhe Franca e tradhtuar nga qeveria e atëhershme e saj, u mund.

Në këtë mënyrë në 12 muajt e parë të luftës, u duk se Gjermania naziste ishte afër realizimit të planeve strategjike të Hitlerit, pushtimin e tërë botës.

Pas mundjes së Francës, hitlerianët mendonin se Anglia kishte për të kapitulluar, por shpresat e tyre nuk u realizuan dhe tentativat për të tërhequr Anglinë nga ana e tyre, duke lidhur një marrëveshje me të, nuk patën sukses.

Kohë më vonë gazeta fashiste "Das Shvarze

Korps" shkroi se anglezët nuk e pranuan propozimin për dorëzim dhe dhanë të kuptojnë se do të luftonin deri në fund. Disa shpresonin se Anglisë do t'i kishin ardhur mendtë dhe do të kishte pranuar një marrëveshje. Mirëpo të gjitha këto parashikime dolën të gabuara."

Kur panë se dështuan planet e tyre kundër Anglisë, ushtria e Hitlerit vendosi të sulmojë në befasi Bashkimin Sovjetik, megjithëse ekzistonte një traktat mosulmimi midis këtyre shteteve e ushtrive.

Duke pushtuar Bashkimin Sovjetik, ata kishin për qëllim të shfrytëzonin resurset e këtij vendi në



dobi të tyre për të sulmuar më pas Anglinë dhe për t'u bërë zotë të kolonive të saj. Më pas radhën do ta kishin Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe vendet e Amerikës Latine.

Strategjia ushtarake gjermane bazohej në luftën e rrufeshme, e përdorur me sukses kjo ndaj shumë vendeve të Europës.

Gjeneralët gjermanë e mendonin ta përballonin luftën me Bashkimin Sovjetik, njësoj si me vendet e tjera me ushtri të dobëta e me territore e sipërfaqe të vogla, duke llogaritur një kohë të përafërt me një muaj e gjysmë deri në dy muaj.

Plani i tyre i përgjithshëm i luftës kundër Bashkimit Sovjetik synonte nga njëra anë në shkatërrimin e menjëhershëm të fuqive kryesore të ushtrisë sovjetike dhe nga ana tjetër të çorganizimit e kundërshtarit me sulmet e fuqishme të aviacionit gjerman, duke prishur ndërlidhjen, komunikimin në tërësi, transportin, sistemin e drejtimit, t'i heqë Komandës Sovjetike mundësinë e mobilizimit, të demoralizojë popullsinë dhe në këtë mënyrë të likuidojë rezistencën e organizuar ndaj forcave gjermane gjatë përparimit të tyre drejt Vollgës e Uraleve.

Sipas gjeneralëve gjermanë dhe planifikimit të tyre nuk kishte nevojë për rezervë të madhe strategjike, pasi sipas tyre forcat do të përdorshin rrufeshëm dhe sulmi do të ishte i fortë dhe shkatërrimtar. Mundësia e dështimit të një sulmi të tillë as që u shkonte në mendje gjeneralëve të komandës supreme gjermane.

Gjatë fushatës së parë verore, ushtria sovjetike pësoi humbje serioze.

Gjermania sipas lajmeve të shtypit të huaj të kohës, hodhi kundër Bashkimit Sovjetik 180 divizione. Shpejtësia e sulmit i siguroi komandës gjermane pasjen e iniciativës në favor të vet. Para ushtrisë së madhe gjermane, në kufirin gjermano-sovjetik të mobilizuar e të vendosur me kohë u ndodhën fuqi të pakta ushtarake sovjetike, vetëm ato të gatishmërisë së përhershme. Më pas filloi mobilizimi në tërësi.

Iniciativa operacionale i lehtësonte forcat gjermane në drejtimin operativ të trupave të tyre.

Përdorimi i aviacionit, desantit ajror dhe i trupave të mekanizuar nga gjermanët, u jepte atyre mundësinë të përparimit në luftimet e para dhe të realizonin brenda një kohe të shkurtër planet që kishin përgatitur. Përparimi i tyre u bë pa mbuluar krahët, gjë që në luftimet e mëvonshme do t'i dëmtonte.

Gjatë muajit qershor 1941 dhe gjysmës së parë të korrikut, propaganda e Gebelsit propagandonte se veprimet luftarake gjermane kundër ushtrisë sovjetike po zhvilloheshin sipas planit, që në realitet nuk qëndronte, pasi nuk pasqyroheshin dobësitë e ushtrisë gjermane.

Në korrik 1941 brenda pak kohe, vendi u përgatit për luftë dhe për organizimin e mbrojtjes ndaj armikut.

Duke u tërhequr, nën presionin e forcave të shumta armike, ushtria sovjetike i shkaktoi ushtrisë gjermane humbje të rënda duke i dobësuar njësitë më të mira e të zgjedhura dhe nxori përballë strategjisë së ofensivës masive, atë të mbrojtjes elastike.

Gabimet e komandës gjermane gjatë zhvillimit të luftimeve filluan të duken që në javët e para të operacioneve ushtarake. Rezistenca e vendosur e njësitë të ushtrisë sovjetike i mbajti për një muaj armatat gjermane mbi vijën Luga-Velikie-Luki-Smolensk-Dniepropetrovsk.

Ky qëndrim i detyruar i një ushtrie të shpejtë, që fillimi i dështimit të planeve për pushtimin e rrufeshëm të Rusisë. Duke kërkuar një sukses deciziv, komanda gjermane përgatiti plane të tjera për të përparuar në luftime. Në përpjekjet e tyre të kota për të arritur një fitore të shpejtë, gjermanët humbën miliona ushtarë dhe oficerë nga më të mirët e më të përgatiturit dhe një pjesë të konsiderueshme të materialeve e të teknikës.

Ndërsa ushtria gjermane po pësonte humbje, po zgjerohej fronti i luftimeve të hapura nga rusët. Kështu që në vjeshtën e vitit 1941 gjermanët nuk kishin më forca të mjaftueshme për të arritur objektivat e paracaktuara.

Gjatë 5 muajve të luftimeve, ushtria sovjetike kishte përbulluar sulmet gjermane, kishte dobësuar forcat kundërshtarë dhe kishte pakësuar rezervat e tyre; ndërsa nga ana e saj ruante forcat dhe krijonte rezerva të reja e të fuqishme. Kjo i krijoi mundësinë për kalimin në kundërmësimje të përgjithshme.

KUNDËROFENSIVA E USHTRISË SOVJETIKE

Në fund të nëntorit 1941 filloi etapa e re e luftës, kalimi në kundërofensivë e ushtrisë sovjetike (ushtrisë së kuqe).

Sulmi i parë u krye në Jug. Po afrohej dimri i ashpër rus. Komanda gjermane bënte çmos të arrinte suksesin para ardhjes së dimrit e ngrirjeve. Përveç ofensivës drejt Moskës, që kërkonte një përqendrim të madh forcash, gjermanët filluan njëkohësisht veprime të gjëra ofensive edhe në Jug.

Barra kryesore e trupave sovjetike mbi frontin jugor ishte shfarosja e njësitë kryesore të trupave të gjeneralit Kleist në zonën e Rostovit.

Prej 20-23 nëntorit 1941, me një kundërofensivë të papritur, trupat sovjetike shkatërruan rigrupimin e forcave armike, të cilat mbulonin krahët e fuqive kryesore të gjeneralit Kleist në Veri.

Duke ndjekur armikun në tërheqje, njësitë

lagjet veri-lindore të qytetit Rostov. Në të njëjtën kohë njësi të tjera të ushtrisë sovjetike filluan ofensivën në veri të Rostovit. Ndër luftimet afër Rostovit dhe gjatë tërheqjes së çrregullt në drejtim të Taganrogut, trupat gjermane pësuan humbje të mëdha. Kjo ofensivë kishte gjatësi të madhe strategjike ndërsa thellësia strategjike shkonte në 100 kilometra. Kjo bëri të mundur që në frontin jugor të qytetit Rostov, në një gjatësi prej dhjetëra kilometrash iniciativa të kalonte në duart e komandës sovjetike.

Prestigjiti të ushtrisë së Hitlerit iu dha një goditje e rëndë. Për të parën herë, pas më tepër se dy vjet luftë, gjermanët humbën një qendër të madhe të banuar, të pushtuar më parë prej tyre. Për herë të parë trupat gjermane u detyruan të tërhiqen në një largësi prej 100 kilometrash, duke pësuar humbje të ndjeshme në njerëz dhe armatime.

Plani operativ sovjetik triumfoi mbi planin e përgjithshëm strategjik gjerman dhe konkretisht mbi planin operativ për mbajtjen e Rostovit dhe për vazhdimin e mëtejshme të mësymjes.

Pra u përballën dy strategji të ndryshme ushtarake dhe dy plane konkrete operative, njëri i mësymjes dhe tjetri i mbrojtjes e kundërmësymjes.

Më 9 dhjetor 1941, trupat sovjetike i thyen plotësisht trupat e gjeneralit gjerman Schmidt dhe pushtuan qytetin Tikhvin. Pas katër ditësh trupat sovjetike në një sektor tjetër të frontit morën qytetin Lelez. Këto fitore të ushtrisë sovjetike paralajmëronin dhe përgatitnin suksesin

e dytë drejt Moskës, në të cilën merrnin pjesë 50 divizione.

Ushtria naziste kishte vendosur të rrethojë dhe të pushtojë me çdo kusht kryeqytetin sovjetik, por ata nuk arritën të merrnin krahët e mbrojtjes sovjetike dhe nuk siguruan dot rrethimin e Moskës, duke mos arritur kështu objektivat e paracaktuara.


Beteja e Dnjeprit

Trupat sovjetike të frontit perëndimor, pasi e dërmuan armikun pranë Moskës, në luftime të ashpra e të pareshtura që zgjatën disa ditë, më 6 dhjetor 1941, kaluan në kundërofensivë mbi krahët e forcave armike.

Armikun iu shkaktuan humbje të rënda në njerëz dhe teknikë. U shpartalluan dhjetëra divizione gjermane dhe kjo detyroi forcat gjermane të tërhiqeshin drejt perëndimit.

Gjatë ofensivës prej 6-10 dhjetor 1941 njësitë e ushtrisë sovjetike dëbuan gjermanët nga 40 qendra banimi, kapën 386 qerre të armatosura, 4317 automjete, 305 topa, 101 mortaja, 515 mitraloza, dhe 516 pushkë automatike. Përveç shumë avionëve armikun iu shkatërruan 271 qerre të armatosura, 565 automjete, 92 topa, 119 mortaja dhe 151 mitraloza. Gjithashtu u kap edhe një sasi e madhe materialesh lufte. Gjermanët lanë në fushën e luftës, pa llogaritur të plagosurit, mbi 30 mijë ushtarë e oficerë.

Duke e zgjeruar ofensivën njësitë e ushtrisë sovjetike pushtuan brenda pak kohe qytetin



sovjetike përparuan 60 kilometra nga pikat e nisjes. Në këtë mënyrë udha për një ofensivë të mëvonshme u hap. Komanda gjermane nuk e kuptoi gjendjen e re që u krijua. Ajo e gjykonte thyerjen e njësitë të veta si një humbje të pjesshme, me rëndësi vetëm lokale. Disfata që pësuan më vonë që e papritur për gjermanët.

Më 28 nëntor 1941 trupat e gjeneralit rus Remisov kapërcyen lumin Don dhe shpërthyen në pjesën jugore të periferisë së Rostovit. Natën e 29 nëntorit njësitë e gjeneralit Kharitonov pushtuan

tjetër të ardhshëm, atë të fitores së betejës për Moskën. Ofensiva e parë drejt Moskës e filluar nga gjermanët, më 2 tetor, kishte dështuar që në fillim të nëntorit. Fronti sovjetik u vendos përkohësisht 80-100 kilometra larg Moskës.

Operacionet ushtarake ishin në një periudhë pauze

Për të mbuluar humbjet e rënda që patën në luftimet e tetorit, gjermanët përqendruan rezerva të mëdha dhe nga gjysma e nëntorit filluan ofensivën

Klin. Trupat e frontit të Leningradit shpartalluan krejtësisht njësitë e divizioneve 11 e 91 dhe regjimentin e dytë të Divizionit 254 të fanterisë armike dhe pushtuan zonën dhe stacionin e Voibokalos.

Në përfundim të vitit 1941, pas thyerjes së Armatës së dytë të motorizuar, të komanduar nga gjeneral kolonel Guderian pranë Tulas, trupat sovjetike të frontit perëndimor çliruan Fominskun, Akeksin dhe qindra qytete të vogla e fshatra. Më 30 dhjetor u çlirua qyteti Kaluga.



REKRUTIM
FORCAT E ARMATOSURA
TË SHQIPËRISË



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**FORCAT
E ARMATOSURA**

**NË KËMBË
PËR KOMBIN!**

Qendra e Personel Rekrutimit vijon regjistrimin e kandidatëve për studime në Akademitë Ushtarake të Shteteve të Bashkuara të Amerikës:

- Akademia Ushtarake Detare, 6 (gjashtë) kuota
- Akademia Ushtarake "West Point", 6 (gjashtë) kuota

AFATI KOHOR PËR DORËZIMIN E DOKUMENTACIONIT PRANË QENDRËS SË PERSONEL REKRUTIMIT ËSHTË DERI MË 15 SHTATOR 2023.